REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 314/20
Datë/Datum. 01.06.20
PRISHTINË / PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI IEKSPERTIT SHQYRTUES

***Ilaz Papaj**-Ekspert Shqyrtues*	*Data e autorizimit të ekspertit 21.05.2020*	*Data e dorëzimit të raportit 01.06.2020*	*Nr. i lëndës: 314/20*

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën:18.05.2020,OE **NTP"Euro Kosova"Shpk** - Prishtinë,ka parashtruar ankesë me nr: 314/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë **OE N.T.SH "Nord"** -Prishtinë,lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Furnizim me material higjenik"**,me nr.prokurimi 701-20-1272-1-2-1,iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) –**"QKUK"**
Autoriteti kontraktues ka zbatuar **procedurë të hapur**,lloji i kontratës:**Kontratë Publike Kornizë, Furnizim,** vlera e parashikuar e kontratës: **123,400.00 €.**

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

(Të përshkruhendispozitat e shkelura dhe vetëm pikat e ankesës).

Neni 1 i LPP-së
Neni 6 i LPP-së
Neni 7 i LPP-së
Neni 59 i LPP-së
Neni 72 i LPP-së

Duke ju referuar shkresës"Letër standarde për tenderuesin e pasuksesshëm'të datës 29.04.2020,për njoftimin për dhënie të kontratës për tenderin me Titull "Furnizim me material hixhenik" me numër të prokurimit:701-20-1272-1-2-1,Nr i brendshëm:701-20-110-121 operatori ekonomik"Euro Kosova"Shpk,Prishtinë është shpallur i pasuksesshëm.

Në bazë të ligjeve në fuqi:LPP nr.04/L-042,neni 10,Ligjit për Qasje në Dokumente Publike nr.03/L-215,si dhe në bazë të Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik të KRPP-së, kemi kërkuar qasje në tenderin me Titull"Furnimzim me material hixhenik"me numër të prokurimit:701-20-1272-1-2-1.

Në bazë të të gjeturave kemi konstatuar dhe kemi vendosur për ankesë ndaj OE-Konsorciumit të suksesshëm në pikën 7.1&7.2 dhe 9.1&9.2 të FDT për kapacitetin teknik dhe profesional,pasi që mendojmë që OE nuk ka plotësuar këto kritere.

Përshkrimi

Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale 7.1&7.2

Kërkesa 1: Certifikatë e regjistrimit të biznesit , regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe ose të korporatës në vendin e juaj të themelimit.

Evidenca 1: Te dëshmohet me Certifikatë te Regjistrimit te Biznesit si dhe me informacione te biznesit-Kopje

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1&9.2

Kërkesa 1: Operatori ekonomik duhet te sjelle nje deklerat per specifikime teknike dhe katalogun

Evidenca 1: Te deshmohet me deklerat per specifikime teknike dhe katalogu.

Kërkesa 2: Operatori Ekonomik duhet te prezantoj ne ofertën e tij se paku 1 (një) reference për realizimin e furnizimeve te ngjashme përgjatë 3 viteve te shkuara nga data e njoftimit për kontratë.

Evidenca 2: Operatori Ekonomik duhet te prezantoj ne ofertën e tij se paku 1 (një) reference për realizimin e furnizimeve te ngjashme përgjatë 3 viteve te shkuara nga data e njoftimit për kontratë.

Të gjeturat

Pas qasjes në dokumentet zyrtare ku ne bazë të LPP kemi kërkuar dokumentet nga dosja e dorëzuar e OE fitues.Kemi evidentuar që OE N.T.Sh'NORD",TRINGË SMAJLI,-PRISHTINË,Kosovë nuk i ka plotësuar kriteret e paraqitura në dosjen e tenderit"Furnizim me material hixhenik"përkatësisht FDT.OE i mungon certifikata e re me numër Unik Identifikues,si dhe i mungojnë aktivitetet adekuate që merren me këtë veprimtari.OE N.T.SH "NORD" ka vetëm këto aktivitete:

222-Primar-Shtypje të tjera

223-Të tjera-Lidhja dhe punët përfundimtare

5247 –Të tjera –Tregtia me pakicë e librave,gazetave,mallit prej letre dhe mjeteve të shkrimit.

Prandaj konstatojmë që në dokumentet e paraqitura nga N.T.SH "NORD" pranë AK nuk figuron dhe i mungon aktiviteti 1722-Prodhimi i artikujve prej letrës me përdorim familjar dhe sanitar,letrës së tualetit dhe aktiviteti 4690-Tregtia me shumicë jo e specializuar.

Në dosjen e tenderit të N.T.SH "NORD" të dorëzuar në AK mungon katalogu i produkteve.

Gjithashtu,OE i mungon një referencë e kërkuar sipas FTD.OE ka përshkruar një listë të kontratave me një klient Ndërmarrja Tregtare Librare"Rilindja" në Skenderaj.Si dhe ka paraqitur një faturë,por jo një referencë nga klienti të cilin e ka furnizuar siç kërkohet në FDT në Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1&9.2

Pas kërkesës tonë për rishqyrtim të vendimit të AK,fillimisht është marrë Vendimi për Pezullim me datë 05.05.2020, dhe pastaj vendim refuzimi i kërkesës për Rishqyrtim me datë 08.05.2020.

Në vendim shkruan që refuzohet si e pabazuar kërkesa për rishqyrtim me arsyetimin "Operatori Ekonomik me ofertën më të lirë me anë të sqarimeve konform nenit 72 i plotëson të gjitha kriteret dhe e ka çmimin më të lirë.

Në kërkesën tonë të dytë për qasje në dokumente zyrtare duke kërkuar nga AK se çka ka kërkuar nga OE,kemi marrë përgjigjie se pas kërkesës për sqarime në fazën e rivlerësimit pas kërkesës tonë për rishqyrtim AK ka pranuar nga OE Nord një referencë dhe katalogun.

Sa për sqarim AK ka të drejtë sipas Nenit 72 të kërkoj sqarime konform nenit 72 të LPP gjatë fazës së vlerësimit,por jo edhe në fazën e rivlerësimit. **AK ka bërë shkelje me këtë kërkesë duke diskriminuar OE të tjerë pjesëmarrës.**

Referenca e dërguar nga OE Nord ka të bëjë me furnizimin e një OE Rilindja në Skenderaj që sipas aktiviteteve ekonomike është një biznes mikro që shet gazeta dhe libra.Ne si shkelje kemi përshkruar edhe mungesen e kodeve ekonomike adekuaate të OE Nord,që merren me prodhim të letrës higjenike.Gjithashtu,AK nuk ka kërkuar nga OE sqarime rreth aktiviteteve ekonomike pasi që OE i shpallur fitues nuk ka veprimtari adekuate.

Përfundim:

Kërkojmë nga autoriteti i juaj: OSHP që të aprovoni ankesën tonë dhe të rekomandoni AK që të shpall fitues OE të përgjegjshëm me çmimin më të lirë duke anuluar vendimin dhe të shpall fituesin aktual si të papërgjegjshëm.

KRITERET PËR VLERËSIM

Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale 7.1&7.2

Kërkesa 1: Certifikatë e regjistrimit të biznesit , regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial

dhe ose të korporatës në vendin e juaj të themelimit.

Evidenca 1: Te dëshmohet me Certifikatë te Regjistrimit te Biznesit si dhe me informacione te biznesit-Kopje

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1&9.2

Kërkesa 1: Operatori ekonomik duhet te sjelle nje deklerat per specifikime teknike dhe katalogun

Evidenca 1: Te deshmohet me deklerat per specifikime teknike dhe katalogu.

Kërkesa 2: Operatori Ekonomik duhet te prezantoj ne ofertën e tij se paku 1 (një) reference për realizimin e furnizimeve te ngjashme përgjatë 3 viteve te shkuara nga data e njoftimit për kontratë.

Evidenca 2: Operatori Ekonomik duhet te prezantoj ne ofertën e tij se paku 1 (një) reference për realizimin e furnizimeve te ngjashme përgjatë 3 viteve te shkuara nga data e njoftimit për kontratë

RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:

Komisioni i vlerësimit me datë 24.04.2020 në raportin e tyre rekomandojnë për kontratë ofertën e OE N.T.SH"Nord" me çmim më të lirë prej 87,920.00 €

Sa i përket ofertës së OE ankues "Euro Kosova"Shpk € nga komisioni i vlerësimit kjo ofertë është shpallur e pasuukseshme sepse ka çmim më të lartë sesa oferta fituese.(89,820.00 €)

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIMEVE TË KERKUARA NGA E EKSPERTËVE SHQYRTUES DHE / OSE TEKNIK

-Kërkesë për informacione/dokumente shtësë nga OE i rekomanduar për kontratë lidhur me dëshminë e pagesës në bankë.
- Kërkesë për informacione shtesë nga ATK për librin e blerjes

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP-së

(Të jepet një vlerësim se OE ankues është apo nuk është palë me interes sipas nenit 4.1.26).

///

VENDIMET E MËPARSHMETË PSH-së LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

(Të sqarohet nëse për rastin e njejtë është dhënë vlerësim tjetër).

///

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

(Të sqarohet për rastin se pse është devijuar nga praktika e mëparshme).

///

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES "EURO KOSOVA"SHPK -PRISHTINË

Përgjigje në Pretendimin 1

Lidhur me pretendimin e OE ankues"Euro Kosova"se AK gjate fazës së vlerësimit,ekzaminimit dhe krahasimit të tendereve ka rekomanduar për kontratë ofertën e OE N.T.SH"Nord" edhe pse kjo ofertë nuk është konform kërkesave të dosjes së tenderit,konkretisht nuk përmbush kërkesat e përshtatshmërise profesionale,ku sipas OE ankues OE të rekomanduar për kontratë i mungon çertifikata e re me numër Unik Identifikues si dhe i mungojnë aktivitetet adekuate që merren me këtë veprimtari,eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Ne dosjen e tenderit tek kërkesat e pershtatshmërise profesionale,konkretisht kërksa 1.nga OE është kërkuar "Çertifikatë e regjistrimit të biznesit ,regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe ose të korporatës në vendin e juaj të themelimit e dëshmuar me Certifikatë te Regjistrimit te Biznesit si dhe me informacione te biznesit-Kopje.

OE i rekomanduar për kontrate N.T.SH "Nord" në ofertën e tij ka dorëzuar edhe çertifikatën e regjistrimit të biznesit me numër të biznesit"70777592" se bashku me informacionet e biznesit.
Sa i përket pretendimit të OE ankues se kjo çertifikatë nuk është e re dhe i mungon numri Unik Identifikues,eksperti shqyrtues sqaron se ka verifikuar në faqen zyrtare të Agjencisë së regjistrimit të Bizneseve të Kosovës (ARBK) dhe OE N.T.SH"Nord" rezulton i regjistruar me numer Unik Identifikues 810912718, emër të biznesit "Nita Macaula"B.I. dhe emër tregtar N.T.SH'Nord"
Sa i përket aktiviteteve në informacionet e biznesit se nuk jane adekuate,eksperti shqyrtues sqaron se në kërkesen e dosjes së tenderit nuk është kërkuar që OE duhet të jenë të regjistruar me ndonje aktivitet specifik por vetëm është kërkuar çertifikata e biznesit.
Konsideroj qe çertifikata e dorëzuar nga OE i rekomanduar për kontratë ësjtë konform kërkesës së dosjes së tenderit dhe pretendimi ankimor është i pa bazuar.

Përgjigje në Pretendimin 2.

Sa i përket pretendimit tjetër se OE i rekomanduar për kontratë nuk përmbush kërkesët mbi mundësite teknike dhe profesionale,konkretisht kërkesën 1,ku sipas OE ankues,OE i rekomanduar për kontratë nuk ka dorëzuar një reference për realizimin e furnizimeve të ngjashme por ka dorëzuar nje faturë dhe fletëdërgese për furnzimin e bërë për klientin/OE "Rilindja" Skenderaj dhe sipas OE ankues kjo dëshmi nuk është konform kërkesës së dosjes së tenderit,eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Ne dosjen e tenderit tek kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale,konkretisht kërksa 1.nga OE është kërkuar të prezantoj ne ofertën e tij se paku 1 (një) reference për realizimin e furnizimeve te ngjashme përgjatë 3 viteve te shkuara nga data e njoftimit për kontratë.

OE i rekomanduar për kontrate N.T.SH "Nord" në ofertën si dëshmi për realizimin e furnizimive të ngjashme ka dorëzuar nje fature dhe fletërdërgese me nr.74-210-001-20 të datës 03.04.2020 në vlerë prej 450.00 € si furnizim(shitje) i realizuar ndaj blerësit N.T.L'Rilindja" Skenderaj.
Gjatë afatit të kërkesës për rishqyrtim të paraqitur nga OE ankues "Euro Kosova", AK konfom nenit 72 të LPP-së ka kërkuar nga OE i rekomanduar për kontratë që të dërgoj referencën dhe katalogun e produkteve sipas kërkesës së dosjes së tenderit,dhe pas kësaj kërkese OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar katalogun dhe nje referënce nga OE N.T.L'Rilindja" Skenderaj të datës 03.04.2020.

Me datë 28.05.2020 përmes e-mailit nga OE i rekomanduar për kontratë kam kërkuar dëshminë e pagesës për këtë transkacion nëse pagesa është bërë përmes transferit bankar.
Në të njejtën datë nga OE i rekomanduar për kontratë kam pranuar një përgjigje që kjo pagesë është bërë më para të gatshme(cash) dhe nuk është realizuar përmes transferit bankar (sipas rregullave të ATK-së pagesat deri ne 500.00 € mund të bëhen me para të gatshme (cash).
Gjithashtu nga OE i rekomanduar për kontratë kam pranuar edhe kartelen financiare për transakcionin e realizuar,librin e arkës dhe librin e shitjes në të cilat rezulton i realizuar ky transakcion sipas datës dhe shumës së njejtë dhe në emër të njejt të blersit.(N.T.L "Rilindja").

Me datë 01.06.2020 nga ATK kam kërkuar dëshmi për librin e shitjes për OE N.T.L "Rilindja" (blersi i mallit nga OE "Nord"Shpk) për të verifikuar nëse transkacioni është regjistruar në librin e blerjes,por ndoshta edhe përshkak të kohës së shkurtër apo edhe situatës në administratën e institucionit(pandemia covid -19) nuk kam pranuar përgjigjie nga ATK.

Gjithsesi në bazë të dokumenteve të dërguara dhe sqarimeve të më sipërme për ekspertin shqyrtues,OE i rekomanduar për kontratë përmbush këtë kërkese të dosjes së tenderit.

Pretendimi ankimor është i pabazuar

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të **refuzohet si e pabazuar** dhe rekomandon autoritetin kontraktues që të **vazhdoj** me lidhjen e kontratës.

Raporti i eksperizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – QKUK
- Panelit Shqyrtues – OSHP.
- OE ankues – "EURO KOSOVA" SHPK